



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr. 7 Regj.Them.**

**Datë Regj. 27.03.2023**

**Nr.6 VENDIMI**

**Datë 30.03.2023**

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtar:** Sokol IBI (*Relator*)  
**Gjyqtare:** Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)  
**Gjyqtare:** Edlira PETRI (*Anëtare*)  
**Gjyqtare:** Manjola XHAXHO (*Anëtare*)  
**Gjyqtare:** Esmeralda XHILI (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë 30.03.2023, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr. 7 Akti, datë 27.03.2023 që i përket:

**PADITËS:** **Partia Demokratike e Shqipërisë**, me seli në Tiranë, Rr. “Donika Kastrioti”, nr. 3, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa, pajisur me autorizim datë 22.03.2023.

**IPADITUR:** **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar nga znj. Pavlina Doçaj dhe/ose Ina Osmanaj, pajisur me autorizim nr.2222 prot., datë 29.03.2023

**PERSON I TRETË:** Koalicioni “BASHKË FITOJMË”, përfaqësuar nga Z.Altin Kaziaj dhe Z.Franci Nuri, pajisur me autorizim nr. 146 prot., datë 17.03.2023.

**OBJEKTI:**

1. Shfuqizimi i vendimit nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” ”,
2. Shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.
3. Plotësimin e të metave nga ana e kërkuesit Partia e Lirisë duke ndryshuar marrëveshjen e koalicionit duke hequr Partinë Demokratike të Shqipërisë nga referimi në këtë dokument.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 21, 64, 65, 66, 124, 124/1, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor; nenet 1 dhe 2 të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, ku:

**Pala paditëse,** Partia Demokratike e Shqipërisë që kërkoi: Pranimin e padisë sipas objektit;

**Pala e paditur,** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që kërkoi: Rrëzimin e kërkesë padisë;

**Personi i tretë**, Koalicioni “BASHKË FITOJMË” kërkoi: Rrëzimin e kërkesë padisë.

## VËREN:

Pala paditëse, Partia Demokratike e Shqipërisë i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar padinë me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 32 datë 23.03.2023 të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”; Shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”; Plotësimin e të metave nga ana e kërkuesit Partia e Lirisë duke ndryshuar Marrëveshjen e Koalicionit duke hequr Partinë Demokratike e Shqipërisë nga referimi në këtë dokument”*”,

### **I. FAKTET E ÇËSHTJES:**

1. Pala paditëse/subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë<sup>1</sup> është parti politike në Shqipëri me kryetar të komanduar/nënkryetar të saj z. E.Alibeaj.

2. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

3. Më datë 15.03.2023 pranë palës së paditur KQZ është paraqitur një kërkesë me nr. 143 prot., datë 15.03.2023 me lëndë: *Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023*” nga ana e Partisë së Lirisë. Me këtë kërkesë, mbështetur në nenin 65 e vijues të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Partia “PARTIA E LIRISË”, si parti udhëheqëse e koalicionit, kërkon

---

<sup>1</sup> Me vendimin nr. 179, datë 18.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të vendimit nr. 27, datë 16.3.2023, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, “Për regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ka vendosur: *Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me shkronja nistore “PDSH”, me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*

regjistrimin e koalicionit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Emri i koalicionit është: “BASHKË FITOJMË”. Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: “BF”. Partitë përbërëse të koalicionit janë: Partia e Lirisë; Partia Demokratike e Shqipërisë; Partia Demokristiane; Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut. Në përputhje me kërkesat e dispozitës së sipërpërmendur të Kodit Zgjedhor, së bashku me kërkesën është paraqitur edhe marrëveshja përkatëse e cila detajon të gjitha elementet e kërkuara nga neni 65 i Kodit Zgjedhor dhe nga Udhëzimin nr. 1 datë 23.12.2020 i KQZ-së. Në vijim, me shkresën nr. 1694 prot., datë 15.3.2023, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese “Partia e Lirisë”, i janë drejtuar KQZ për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PD-PDK-PBDNJ), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur:**

*1. Regjistrimin e Koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PDK-PBDNJ), “BF”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:*

*a) “Partia e Lirisë” (PL);*

*b) “Partia Demokristiane e Shqipërisë” (PDK);*

*c) “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ).*

*2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

*3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.*

**4.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndër të tjera ka arsyetuar:**

*Citim: “...Koalicioni Zgjedhor “BASHKË FITOJMË”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.*

Bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ– së janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore partitë politike si më poshtë vijon:

1. “Partia e Lirisë” me kryetar z. Ilir Metaj, miratuar me vendimin, nr. 154, datë 9.3.2023;
2. “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar z. Sali Berisha nuk është e regjistruar si subjekt zgjedhor;
3. “Partia Demokratiane e Shqipërisë” me kryetar z. Nard Ndoka, miratuar me vendimin, nr. 111, datë 8.3.2023;
4. “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” me kryetar z. Vangjel Dule, miratuar me vendimin nr. 135 datë 8.3.2023;

Me shkresën nr. 1694 prot., datë 15.3.2023, në zyrën e protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga partia përfaqësuese “Partia e Lirisë”, kërkojnë regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PD-PDK-PBDNJ), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “BASHKË FITOJMË” (PL-PD-PDK-PBDNJ), është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “BASHKË FITOJMË” (PL-PD-PDK-PBDNJ);
3. Shkronjat nistore të koalicionit “BF”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Autorizimin e z. Ilir Metaj, kryetar i partisë “Partia e Lirisë”/ ose të autorizuarin prej tij, të dorëzojë listat shumemërore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit;
6. Fushata e koalicionit “Bashkë Fitojmë” do të drejtohet nga “Partia e Lirisë”;
7. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
8. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;

9. Autorizimin e z. Endrit Braimllari, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ;

10. Numri i kandidatëve dhe renditja e tyre do të do bëhet sipas marrëveshjes midis palëve.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor.

1. Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.

2. Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kushti i tretë është numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se, kërkesa për t'u regjistruar si koalicion, është e bazuar për tre nga partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. "Partia e Lirisë" me kryetar z. Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 154, datë 9.3.2023;

2. "Partia Demokratiane e Shqipërisë" me kryetar z. Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 111, datë 8.3.2023;

3. "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut" me kryetar z. Vangjel Dule regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 135 datë 8.3.2023.

Në seancën publike të zhvilluar në datën 18.3.2023, përfaqësuesi i autorizuar i Partisë së Lirisë, kërkoi regjistrimin si subjekt zgjedhor të koalicionit "BASHKË FITOJMË" BF.

Përfaqësuesi i "Partisë Demokratike", z. Sefa u shpreh se kërkesa është në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas z. Sefa kërkesa e paraqitur nga Partia e Lirisë, "Partia Demokratiane e Shqipërisë", "Partia Demokratiane e Shqipërisë", "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut", pjesë e marrëveshjes cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor "Partia Demokratike" pasi në të kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen e sipërcituar. Sipas përfaqësuesit të PD përdorimi i emrit të Partisë Demokratike nga një subjekt tjetër përbën shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 66 të tij. Vetë Partia Demokratike, pretendoi përfaqësuesi i saj, nuk është pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor në këto zgjedhje dhe nuk ka asnjë vullnet për të hyrë në koalicion.

*Komisionioneri Qendror i Zgjedhjeve, çmon të drejta pretendimet e përfaqësuesit z. Sefa, se kërkesa e paraqitur nga Partia e Lirisë cenon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” pasi sipas kësaj kërkesë kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen “Partia e Lirisë”, “Partia Demokratike e Shqipërisë”, “Partia Demokratike e Shqipërisë”, “Partia Demokratike e Shqipërisë”, “Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”. Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar z. Sali Berisha nuk përmbush kushtet e nenit 65, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk rezulton të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, e si e tillë nuk mund të jetë pjesë e këtij Koalicioni”.*

**5.** Kundër këtij vendimi pala paditëse/subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur ankesë më datë 20.03.2023 në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt: *Shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, duke parashtruar ndër të tjera se:*

*(Citim) “...Me shkresën nr. 143 prot., datë 15.03.2023, Partia e Lirisë ka paraqitur kërkesën me objekt “Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor”. Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjendet autorizimi për Z. Endrit Braimllari dhe marrëveshja e koalicionit. Në kërkesën paraqitur për miratim rezulton se subjektet kërkuese dhe pjesëmarrëse në marrëveshje janë Partia e Lirisë, Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Po kështu marrëveshja e paraqitur së bashku me kërkesën për regjistrim përmban edhe nënshkrimin e subjektit të pretenduar Partia Demokratike e Shqipërisë e nënshkruar nga shtetasi Sali Berisha në cilësinë e pretenduar të kryetarit të kësaj partie.*

*Gjatë shqyrtimit në seancën e datës 18.03.2022 subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Z. Indrit Sefa, në cilësinë e përfaqësuesit të përhershëm të këtij subjekti politik në KQZ ka marrë pjesë aktive në debatin në lidhje me regjistrimin e koalicionit BF duke parashtruar argumenta lidhur me detyrimin e KSHZ për refuzimin e kësaj kërkesë. Argumentat e paraqitur janë marrë pjesërisht në konsideratë nga KSHZ vetëm për pjesën me të cilën ky i fundit ka refuzuar të përfshijë si pjesëmarrës në koalicion subjektin e pretenduar Partia Demokratike e*

*Shqipërisë, e përfaqësuar nga shtetasi Sali Berisha në cilësinë e pretenduar të kryetarit të kësaj partie.*

*Pavarësisht vendimit përfundimtar të Komisionerit, në aktet e depozituara në KQZ vijon të rezultojë si pjesë e kërkesës, pjesë e marrëveshjes dhe për pasojë edhe pjesë e pretenduar e koalicionit subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, fakt i cili në opinionin e gjerë publik krijon paqartësi lidhur me pjesmarrjen e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë në koalicionin “Bashkë Fitojmë”.*

*Një nga parakushtet formale të nevojshme për shqyrtimin e një ankimi të paraqitur ndaj vendimeve të KSHZ është legjitimiteti i palës kërkuese. Legjitimiteti në vetë vendimet e KAS apo Kolegjit Zgjedhor përcaktohet si interesi i ligjshëm i një pale. Në lidhje me jurisprudencën zgjedhore sa i përket ankimeve nga një subjekt zgjedhor ndaj veprimtarisë së një subjekti zgjedhor në formën e një koalicioni pjesë e të cilit ai nuk është, ankuesi i referohet edhe vendimit nr. 9, datë 23.03.2021 të vetë Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve ku ka legjitimuar subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në ankimin e saj ndaj një vendimarrjeje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për listën e kandidatëve të subjektit zgjedhor koalicionit PD-AN. Ky qëndrim (në lidhje me interesin e ligjshëm) u konfirmua dhe nga Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 3, datë 29.03.2021 të tij. Madje, Kolegji Zgjedhor, duke argumentuar se “... nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë plotësohen në përputhje me ligjin zgjedhor, i cili gjen njësoj zbatim edhe prej subjekteve të tjera zgjedhore” i ka bërë një interpretim të zgjeruar interesit të ligjshëm të subjekteve zgjedhore në zgjedhje. Në këtë kontekst është tërësisht i provuar legjitimiteti i palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë për ngritjen dhe marrjen në shqyrtim të këtij ankimi.*

*Në lidhje me përmbajtjen e kërkesës dhe marrëveshjes.*

*Në këtë pjesë ankuesi këmbëngul në ligjshmërinë e përmbajtjes së kërkesës dhe marrëveshjes së koalicionit. Konkretisht, në faqen e parë të kërkesës thuhet “Emri i koalicionit është “Bashkë Fitojmë ” (PL-PD-PDK-PBDNJ)”, po në faqen e parë vijon: “Partitë përbërëse të koalicionit janë: “Partia e Lirisë; Partia Demokratike e Shqipërisë; Partia Demokratike e Shqipërisë; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”. Ndërsa, në marrëveshje thuhet “Drejtuese politike e koalicionit është Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga organet drejtuese të saj”*

*Neni 65, pika 1 e Kodit Zgjedhor, siç me të drejtë arsyeton edhe Komisioneri në vendimarrjen e tij, përcakton tre kushte për regjistrimin e një koalicioni zgjedhor:*



1. Koalicioni formohet vetëm nga parti politike. 2. Partia politike të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ. 3. Numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë. Kuptohet që të tre këto kushte janë kumulative dhe pranimi i një kërkesë për regjistrim koalicioni kërkon përmbushjen e njëkohshme të tyre. Në rastin konkret, rezulton se njëra nga subjektet pjesëmarrëse të koalicionit nuk është parti politike, përkatësisht subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë”, rrjedhimisht ky subjekt nuk ishte i regjistruar as në KQZ si subjekt zgjedhor. Kaq do të mjaftonte në fakt që Komisioneri të vendoste rrëzimin e kërkesës për koalicionin “Shtëpia e Lirisë”.

Por, ndryshe nga sa arsyeton Komisioneri, që përpiqet ta trajtojë marrëveshjen e koalicionit si një dokument formal, Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, imponojnë detyrimin edhe të verifikimit të përputhshmërisë së përmbajtjes të marrëveshjes me ligjin. Konkretisht, një nga kërkesat kryesore të nenit 65 të Kodit dhe nenit 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 është shprehja e qartë e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesë e një koalicioni zgjedhor. Në përmbajtje të kërkesës dhe marrëveshjes ka referenca të qarta ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila për asnjë moment dhe në asnjë rast nuk ka shprehur vullnetin apo dëshirën për të qenë pjesë e një koalicioni të tillë.

Mungesa e këtij elementi thelbësor, pra shprehja e vullnetit nga subjekti zgjedhor për të qenë pjesëmarrës në një koalicion zgjedhor, e bën marrëveshjen të paligjshme dhe imponon detyrimin për KQZ që të refuzojë regjistrimin e saj. Megjithëse, ky element paligjshmërie është konstatuar edhe nga ana e vetë Komisionerit, ai ka vendosur pranimin e kërkesës dhe regjistrimin e saj, duke ndërhyrë dhe ndryshuar vullnetin e kërkuarit. Pra, ndryshe nga sa thuhej në kërkesë për subjektet pjesëmarrëse në koalicionin zgjedhor, Komisioneri ka vendosur regjistrimin e një koalicioni vetëm me tre prej tyre, duke vepruar në fakt në tejkalim të kompetencave të tij. Ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore autorizojnë Komisionerin vetëm të vendosë pranimin apo rrëzimin e një kërkesë, por jo të ndërhyjë në përmbajtjen e saj apo të marrëveshjes së koalicionit për ta sjellë në formën që ai gjykon se është në përputhje me ligjin.

Një tjetër element paligjshmërie në këtë marrëveshje koalicioni është edhe mungesa e përcaktimit të numrit të kandidatëve që duhet të propozojë secila parti politike brenda koalicionit për çdo parti zgjedhore (shih nenin 2, pika 2, gërma “e” e Udhëzimit nr. 1/2020 të Komisionerit). Ky element është veçanërisht i rëndësishëm

*pasi në faqen e parë të marrëveshjes thuhet se drejtuese politike është Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, ndërkohë që në media kanë qarkulluar deklarata nga përfaqësues të Lëvizjes Socialiste për Integrim, se kandidatët do të vijnë nga rradhët e subjektit “Komisioni i Rithemelimit”. Në kushtet kur Komisioneri ka vendosur që të përjashtojë subjektin “Komisioni i Rithemelimit” nga marrëveshja e koalicionit, cili do të jetë subjekti apo partia politike që do të propozojë kandidatët për kryetar bashkie. Marrëveshja nuk e thotë dhe as vendimarrja e Komisionerit nuk jep përgjigje.*

*Këto paqartësi në vendimarrjen e Komisionerit, në fakt janë reflektuar edhe në publik, pasi individë të caktuar, që pretendojnë se janë kandidatë të subjektit “Komisioni i Rithemelimit”, zhvillojnë takime me emër dhe logo të njëjta me ato të Partisë Demokratike (foto bashkëlidhur), duke prodhuar një konfuzion për zgjedhësit, që nenin 66 i Kodit Zgjedhor përpiqet ta eliminojë, në mënyrë që zgjedhësi të jetë shumë i qartë në momentin e votimit lidhur me partinë dhe kandidatin që ai dëshiron të votojë. Argumentet e mësipërme provojnë qartë se në tërësinë e saj, kërkesa dhe marrëveshja e depozituar nga Lëvizja Socialiste për Integrim janë në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe aktet nënligjore, dhe si të tilla duhen rrëzuar”.*

**6.** Me vendim nr. 32, datë 23.03.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ka vendosur:

- 1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”,*
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;*
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.*

**6.1. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:**

*Citim: “...1.E drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë*

*midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme.*

*2. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, KAS çmoi së pari të marrë në shqyrtim çështjen e legjitimitetit aktiv. Që kërkesa ankimore të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore: a) interesi i ligjshëm; b) legjitimiteti për të vepruar. Interesi i ligjshëm, sipas arsytimit të vendimit nr. 12, datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë presupozon njohjen e cenimit të një interesi. Interesi i ligjshëm i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të cënuar.*

*3. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja “b” parashikon se, KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitetin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese e cila ngre një pretendim, dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.*

*4. Në momentin e regjistrimit pranë KQZ-së, çdo subjekt zgjedhor e kryen këtë veprim me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cilët subjekte të tjerë do të marrin pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm të paraqiste ankim, kundrejt vendimit të KQZ, për regjistrimin ose jo të vetë subjektit.*

*5. Në rastin konkret ankimuesi, si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga KQZ si i tillë dhe për rrjedhojë nuk i është cënuar asnjë interes i tij. Regjistrimi nga KQZ i çdo subjekti tjetër apo mosregjistrimi i tij nuk cenon interesat e subjektit ankimues. Subjektet zgjedhore përfshirë partitë politike dhe koalicionet, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet e tjera që do të regjistrohen nga KQZ.*

*6. Vullneti që subjekti zgjedhor shpreh duke u rregjistruar, lidhet me interesin e tij të ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje. Kërkesa për mos regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor. Marrja apo mosmarrja pjesë në zgjedhje e çdo partie politike, apo bashkimi të subjekteve në formën e koalicioneve zgjedhore, nuk cënon interesat e ligjshme të ankimuesit si subjekt zgjedhor i rregjistruar. (Shih vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor)*

7. Vlen të theksohet se është standart dhe praktikë zgjedhore që disa subjekte politike kanë përfaqësim të akredituar në KQZ dhe marrin pjesë në procesin administrativ të vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aktet kryesore të procesit, sikundër është regjistrimi i subjekteve zgjedhore. Po ashtu vlen të evidentohet në rastin konkret se, subjekti zgjedhor Partia Demokratike (PD) ka ngritur një pretendim për mos regjistrimin si subjekt zgjedhor pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, të subjektit PD (me kryetar z. Sali Berisha) që në fazën fillestare të paraqitje të kërkesës para Komisionerit.

8. Komisioneri me vendimmarrjen e tij ka regjistruar vetëm koalicionin e përbërë nga PL-PDK-PBDNJ. Në këtë moment pretendimi i ngritur nga PD në KAS, konsiderohet i zgjidhur duke mos pasur më ky subjekt (PD) asnjë “interes të ligjshëm” në kuptim të Kodit Zgjedhor, kundrejt regjistrimit të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, i cili tashmë përbëhet nga tre subjektet zgjedhore, PL, PDK dhe PBDNJ të cilat kanë identitet të qartë dhe të ndryshëm politik nga ankuesi PDSH. Pavarësisht nga marrëveshjet që këto subjekte kanë me njëra-tjetrën apo me grupime të ndryshme që kanë ose jo cilësitë e një subjekti politik, për efekt të kësaj gare zgjedhore, në fletën e votimit që do të kenë zgjedhësit në qendrën e votimit, do të pasqyrohet subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” me shkronjat nistore “BF”, me partitë përbërëse PL-PDK-PBDNJ. Pra vendimmarrja e KSHZ, qartësisht i ka dhënë zgjidhje edhe këtij kërkimi të subjektit Partia Demokratike.

9. Duke qenë se objekt kundërshtimi është vendimi nr. 178, datë 18.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimi të cilin ai kundërshton. Nga spjegimet e përfaqësuesit të subjektit ankimues në seancën paraprake përpara KAS, rezultoi se PD në fakt nuk kundërshton në vetvete regjistrimin e koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë” (i cili udhëhiqet nga Partia e Lirisë në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor), por kundërshton “Deklaratën e Koalicionit” e paraqitur nga partitë përbërëse të këtij koalicioni dhe kjo për shkak se në këtë deklaratë përmendet emri i PDSH si pjesëmarrëse në koalicion. Përfaqësuesi i ankimuesit pranoi faktin se në vendimin objekt ankimi, KSHZ pikërisht sipas kërkesës së vetë partisë ankimuese, nuk e ka përfshirë emrin e PDSH si parti formuese e koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”. Në këtë kontekst, edhe nëse KAS eventualisht do të vendoste të pranonte kërkesën e ankimuesit, sërish do

të ishte i pakuptimtë shfuqizimi i vendimit nr. 178, datë 18.03.2023, sepse edhe në vendimmarrjen pasuese të Komisionerit në raport me koalicionin “Bashkë Fitojmë” do të kishte të njëjtën vendimmarrje. Në këtë kontekst, kërkesa ankimore në fakt është pa objekt.

10. Pjesëmarrja e subjektit PD në fazën e shqyrtimit të regjistrimit të koalicionit nga KSHZ nuk mund të shërbejë si shkak legjitimimi “automatik”, për efekt të ankimit në KAS, si dhe në të njëjtën analogji përpara Kolegjit Zgjedhor. Në cdo rast do duhet që të vlerësohet, nëse ka apo jo interes të ligjshëm të ankuesit pavarësisht qënies si palë në shqyrtimin administrativ.

11. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin nr. 12, datë 24.06.2019, midis të tjerash përcakton se “... sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme...” (Vendimi nr. 91, date 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

12. Po ashtu ky qëndrim është mbajtur edhe më përpara nga KAS, referuar vendimmarrjes së mëparshme të tij, konkretisht vendimit nr. 06, datë 07.02.2021, “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike”. Edhe rasti konkret është pothuajse identik me rastin e trajtuar në vendimmarrjen e mësipërme dhe në këto kushte nuk ka asnjë arsye për ndryshimin e kësaj praktike tashmë të konsoliduar.

13. Përfundimisht, në vlerësimin e anëtarëve në shumicë të KAS, ankimesit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as cënuar interesi i ligjshëm i pretenduar. Për pasojë ai nuk legjitimohet në kundërshtimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të KSHZ-së. Regjistrimi i koalicionit “Bashkë Fitojmë” (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk ndryshon apo cenon kushtet e konkurrimit për asnjë nga subjektet e tjera zgjedhore.

7. Partia Demokratike e Shqipërisë pasi është bërë me dije me vendimin e K.A.S-it, duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova, i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi, depozituar më datë 27.03.2023.

8. Pala paditëse, Partia Demokratike e Shqipërisë në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

- Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit, rezulton se me shkresën nr. 143 prot., datë 15.03.2023, Partia e Lirisë ka paraqitur kërkesën me objekt “Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor”. Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjendet autorizimi për Z. Endrit Braimllari dhe marrëveshja e koalicionit. Në kërkesën paraqitur për miratim rezulton se subjektet kërkuarë dhe pjesëmarrëse në marrëveshje janë Partia e Lirisë, Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Po kështu marrëveshja e paraqitur së bashku me kërkesën për regjistrim përmban edhe nënshkrimin e subjektit të pretenduar Partia Demokratike e Shqipërisë e nënshkruar nga shtetasi Sali Berisha në cilësinë e pretenduar të kryetarit të kësaj partie.
- Gjatë shqyrtimit në seancën e datës 18.03.2022 subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga z. Indrit Sefa, në cilësinë e përfaqësuesit të përhershëm të këtij subjekti politik në KQZ ka marrë pjesë aktive në debatin në lidhje me regjistrimin e koalicionit ‘BF’ duke parashtruar argumente lidhur me detyrimin e KSHZ për refuzimin e kësaj kërkesë. Argumentet e paraqitura janë marrë pjesërisht në konsideratë nga KSHZ vetëm për pjesën me të cilën ky i fundit ka refuzuar të përfshijë si pjesëmarrës në koalicionin subjektin e pretenduar Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga shtetasi Sali Berisha në cilësinë e pretenduar të kryetarit të kësaj partie.
- Pavarësisht vendimit përfundimtar të Komisionerit, në aktet e depozituara në KQZ vijon të rezultojë si pjesë e kërkesës, pjesë e marrëveshjes dhe për pasojë edhe pjesë e pretenduar e koalicionit subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, fakt i cili në opinionin e gjerë publik krijon paqartësi lidhur me pjesëmarrjen e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë në koalicionin “Bashkë Fitojmë”.
- Një nga parakushtet formale të nevojshme për shqyrtimin e një ankimi të

paraqitur ndaj vendimeve të KSHZ është legjitimiteti i palës kërkuese. Legjitimiteti në vetë vendimet e KAS apo Kolegjit Zgjedhor përcaktohet si interesi i ligjshëm i një pale. Në lidhje me jurisprudencën zgjedhore sa i përket ankimimeve nga një subjekt zgjedhor ndaj veprimtarisë së një subjekti zgjedhor në formën e një koalicioni pjesë e të cilit ai nuk është, ankuesi/paditës i referohet edhe vendimit nr. 9, datë 23.03.2021 të vetë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku ka legjitimuar subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë në ankimin e saj ndaj një vendimmarrjeje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për listën e kandidatëve të subjektit zgjedhor koalicionit PD-AN. Ky qëndrim (në lidhje me interesin e ligjshëm) u confirmua dhe nga Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 3, datë 29.03.2021 të tij. Madje, Kolegji Zgjedhor, duke argumentuar se “... nevojat e secilit subjekt zgjedhor, kur merr pjesë në garë plotësohen në përputhje me ligjin zgjedhor, i cili gjen njësoj zbatim edhe prej subjekteve të tjera zgjedhore” i ka bërë një interpretim të zgjeruar interesit të ligjshëm të subjekteve zgjedhore në zgjedhje. Në këtë kontekst është tërësisht i provuar legjitimiteti i palës ankuese Partia Demokratike e Shqipërisë për ngritjen dhe marrjen në shqyrtim të këtij ankimi.

- Nëse një subjekt zgjedhor (neni 124 pika 1 e Kodit Zgjedhor) apo një palë e tretë (neni 124/1 pika 2 e Kodit Zgjedhor) ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Subjekti zgjedhor ose pala e tretë që vë në lëvizje KAS duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë dhe aktit administrativ që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak.
- Në lidhje me përmbajtjen e kërkesës dhe marrëveshjes. Në këtë ankuesi/paditës ndalet në ligjshmërinë e përmbajtjes së kërkesës dhe marrëveshjes së koalicionit konkretisht, në faqen e parë të kërkesës thuhet “Emri i koalicionit është “Bashkë Fitojmë” (PL-PD-PDK-PBDNJ). Po në faqen e parë vijon: “Partitë përbërëse të koalicionit janë: “Partia e Lirisë; Partia Demokratike e Shqipërisë; Partia Demokristiane e Shqipërisë; Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” ndërsa, në marrëveshje thuhet "Drejtuuese politike e koalicionit është Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga

organet drejtuese të saj”.

Neni 65, pika 1 e Kodit Zgjedhor, siç me të drejtë arsyeton edhe Komisioneri në vendimmarrjen e tij, përcakton tre kushte për regjistrimin e një koalicioni zgjedhor: *1. Koalicioni formohet vetëm nga parti politike. 2. Partia politike të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ. 3. Numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë.* Kuptohet që të tre këto kushte janë kumulative dhe pranimi i një kërkesë për regjistrim koalicioni kërkon përmbushjen e njëkohshme të tyre. Në rastin konkret, rezulton se njëra nga subjektet pjesëmarrëse të koalicionit, përkatësisht subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë”, nuk ka dhënë vullnetin që të jetë pjesë e këtij koalicioni dhe kjo e shprehur shprehimisht në seancë publike nga përfaqësuesi i këtij subjekti në KQZ z. Indrit Sefa dhe rrjedhimisht marrveshja e koalicionit përmban të dhëna të pasakta dhe si e tillë nuk do të duhej të pranohej nga ana e Komisionerit. Kaq do të mjaftonte në fakt që Komisioneri të vendoste rrëzimin e kërkesës për koalicionin “Bashkimi për Fitore”.

- Ndryshe nga sa arsyeton Komisioneri, që përpiqet ta trajtojë marrëveshjen e koalicionit si një dokument formal, Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, imponojnë detyrimin edhe të verifikimit të përputhshmërisë së përmbajtjes të marrëveshjes me ligjin. Konkretisht, një nga kërkesat kryesore të nenit 65 të Kodit dhe nenit 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 është shprehja e qartë e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesë e një koalicioni zgjedhor. Në përmbajtje të kërkesës dhe marrëveshjes ka referenca të qarta ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila për asnjë moment dhe në asnjë rast nuk ka shprehur vullnetin apo dëshirën për të qenë pjesë e një koalicioni të tillë. Ky fakt është përmendur në mënyrë të vazhdueshme nga përfaqësuesi në seancë publike.
- Mungesa e këtij elementi thelbësor, pra shprehja e vullnetit nga subjekti zgjedhor për të qenë pjesëmarrës në një koalicion zgjedhor, e bën marrëveshjen të paligjshme dhe imponon detyrimin për KQZ që të refuzojë regjistrimin e saj. Megjithëse, ky element paligjshmërie është konstatuar edhe nga ana e vetë Komisionerit, ai ka vendosur pranimin e kërkesës dhe regjistrimin e saj, duke ndërhyrë dhe ndryshuar vullnetin e kërkuarit. Pra, ndryshe nga sa thuhej në kërkesë për subjektet pjesëmarrëse në koalicionin zgjedhor, Komisioneri ka vendosur regjistrimin e një koalicioni vetëm me tre



- prej tyre, duke vepruar në fakt në tejkalim të kompetencave të tij. Ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore autorizojnë komisionerin vetëm të vendosë pranimin apo rrëzimin e një kërkesë, por jo të ndërhyjë në përmbajtjen e saj apo të marrëveshjes së koalicionit për ta sjellë në formën që ai gjykon se është në përputhje me ligjin.
- Një tjetër element paligjshmërie në këtë marrëveshje koalicioni është edhe mungesa e përcaktimit të numrit të kandidatëve që duhet të propozojë secila parti politike brenda koalicionit për çdo parti zgjedhore (*shih nenin 2, pika 2, gërma “e” të Udhëzimit nr. 1/2020 të Komisionerit*). Ky element është veçanërisht i rëndësishëm pasi, në faqen e parë të marrëveshjes thuhet se drejtuese politike është Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Sali Berisha, ndërkohë që në media kanë qarkulluar deklarata nga përfaqësues të Partia e Lirisë, se kandidatët do të vijnë nga rradhët e subjektit “Bashkë Fitojmë”. Në kushtet kur Komisioneri ka vendosur që të përjashtojë subjektin “Partia Demokratike e Shqipërisë” nga marrëveshja e koalicionit, lind pyetja se cili do të jetë subjekti apo partia politike që do të propozojë kandidatët për kryetar bashkie apo kandidatët për këshillat bashkiak. Marrëveshja nuk e thotë dhe as vendimmarrja e Komisionerit nuk jep përgjigje.
  - Këto paqartësi në vendimmarrjen e Komisionerit, në fakt janë reflektuar edhe në publik, pasi individë të caktuar, që pretendojnë se janë kandidatë të subjektit “Bashkë Fitojmë”, zhvillojnë takime me emër dhe logo të njëjta me ato të Partisë Demokratike, duke prodhuar një konfuzion për zgjedhësit, që neni 66 i Kodit Zgjedhor përpiket ta eliminojë, në mënyrë që zgjedhësi të jetë shumë i qartë në momentin e votimit lidhur me partinë dhe kandidatin që ai dëshiron të votojë. Argumentet e mësipërme provojnë qartë se në tërësinë e saj, kërkesa dhe marrëveshja e depozituar nga Partia e Lirisë janë në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe aktet nënligjore, dhe si të tilla duhen rrëzuar.
  - Në mendimin e pakicës së anëtarëve të KAS të cilët kanë argumentuar dhe nevojën se përse KAS do të duhet të merrte në shqyrtim këtë ankim referohen dhe fakte nga praktika të mëparshme të cilat në mënyrë të ngjashme kanë afektuar dhe zgjedhjet e pjesëshme të 6 marsit 2022.
  - KAS ka dështuar që të vlerësojë qartë interesin e ligjshëm dhe të marrë në shqyrtim një kërkesë të ligjshme të një subjekti zgjedhor ndaj të cilit në

- mënyrë të padrejtë i janë përdorur logo, stema dhe emrin si pjesë e një marrëveshje koalicioni për të cilën ai nuk ka shprehur asnjë vullnet dhe as ka marrë asnjë veprim konkret për të marrë pjesë. Në asnjë moment nuk ka qënë vullneti i këtij subjekti të jetë pjesë e këtij koalicioni.
- Përdorimi i emrit, i logos bëhet me qëllimin e vetëm për të konfunduar zgjedhësit dhe për tu dhënë atyre impresionin që Partia Demokratike është pjesë e këtij koalicioni zgjedhor duke marrë përfitime të padrejta dhe duke konfunduar zgjedhësit. Ky truk zgjedhor do të duhej të ndalohej nga ana e KSHZ dhe nga KAS të cilët do të duhet të mermin të gjitha masat për të qartësuar zgjedhësit për subjektet zgjedhore që do të konkurojnë në zgjedhjet e 14.05.2023.
  - Gjithashtu Partia Demokratike nuk kërkon ç' regjistrimin e koalicionit BF por siç është shprehur në KAS dhe gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga KSHZ ka kërkuar, kthimin me të meta duke i lënë afat përfaqësuesit të koalicionit që të paraqes një Marrëveshje të re Koalicioni ku në të mos të përmendet Partia Demokratike e Shqipërisë, pasi kjo e fundit në asnjë rast nuk e ka dhënë pëlqimin për të qënë pjesë e këtij koalicioni dhe aq më pak të jetë drejtuese politike e tij. Kjo marrëveshje është kryer në kundërshtim me ligjin dhe në mashtrim të tij me qëllimin e vetëm për të mashtruar zgjedhësit dhe për t'i konfunduar ata. Interesi i ligjshëm i PD-së është i qartë dhe si i tillë do të duhet të merret në konsideratë nga ky kolegji i cili të shqyrtojë çështjen në themel dhe të vendos në lidhje me këtë kërkesë duke e pranuar atë.
  - Gjithashtu në zbatim të nenit 156 pika 2 të Kodit Zgjedhor kërkohet që KQZ të depozitojë në Kolegjin Zgjedhor të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ si dhe me rëndësi përbëjnë procesverbalet e seancës publike të transkriptuara në mënyrë që të pasqyrohen qartësisht deklaratimet e përfaqësuesve në seancë publike ku të bëhen të qarta dhe pretendimet e tyre.
  - Për sa më sipër, si konkluzion për shkak se kërkesa dhe marrëveshja përmbajnë referenca te Partia Demokratike e Shqipërisë, në kushtet kur kjo e fundit as nëpërmjet kryetarit të saj apo ndonjë personi tjetër të autorizuar nga ana e tij, nuk ka shprehur vullnetin për të qënë pjesëmarrëse në këtë koalicion. Marrëveshjes i mungon edhe një element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me përcaktimin e numrit të kandidatëve nga secila parti politike. Në kushtet kur subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë” është përjashtuar nga marrëveshja,

mbetet e paqartë se cila parti politike do të propozojë kandidatët e koalicionit; kërkohet të pranohet padia sipas objektit.

9.Pala e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit prapësoi se:

- Në kuadër të procesit ligjor për zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 178/2023 vendosi, regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” si subjekt zgjedhor me parti pjesëtare:
  - 1-Partia e Lirisë (PL);
  - 2-Partia Demokristiane e Shqipërisë (PDK);
  - 3-Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).
- Gjatë shqyrtimit administrativ në fund të të cilit është marrë vendimi i mësipërm, paditësi ka kërkuar që të mos regjistrohet si pjesëmarrës në Koalicionin subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë” me përfaqësues z. Sali Berisha, i cili ishte pjesë e kërkesës së depozituar në KQZ për regjistrimin e Koalicionit.

KSHZ e ka pranuar pretendimin e paditësit, duke mos regjistruar subjektin “Partia Demokratike e Shqipërisë” me përfaqësues z. Sali Berisha, si pjesëtar të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Pavarësisht se pretendimi i paditësit u mor parasysh në vendimmarrjen e KSHZ-së, subjekti paditës e kundërshtoi këtë vendimmarrje në KAS. Gjatë seancës paraprake KAS vendosi mospranimin e ankimit, sepse ky subjekt nuk arriti të provonte legjitimitetin e tij në paraqitjen e ankimit.
- E drejta për të paraqitur një ankim pranë KAS, lidhet me vërtetimin e interesit të ligjshëm që i cenohet subjektit ankues. Në momentin e marrjes së vendimit nga KSHZ për regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, me palë pjesëmarrëse vetëm PL-PDK-PBDNJ, pretendimi i ngritur nga paditësi konsiderohet i zgjidhur duke mos pasur më ky subjekt (PD) asnjë "interes të ligjshëm" në kuptim të Kodit Zgjedhor.

Është pikërisht për këtë arsye që edhe nëse KAS do të vendoste të pranonte kërkesën e ankimesit, sërish do të ishte i pakuptimtë shfuqizimi i vendimit

nr. 178, datë 18.03.2023, sepse edhe në vendimarrjen pasuese të Komisionerit do të kishte të njëjtën vendimarrje.

Në vendimin nr. 12, datë 24.06.2019 të vetë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ku midis të tjerash përcaktohet se "*... sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobia personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cenuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme...*". Ky qëndrim është mbajtur edhe më përpara nga KAS, referuar vendimarrjes së mëparshme të tij, konkretisht vendimit nr. 06, datë 07.02.2021, "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike". Edhe rasti konkret është pothuajse identik me rastin e trajtuar në vendimarrjen e mësipërme dhe në këto kushte nuk ka asnjë arsye për ndryshimin e kësaj praktike tashmë të konsoliduar.

- Në padinë e tij, paditësi referon vendimit nr. 9, datë 23.03.2021 "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 05, datë 19.03.2021 të koalicionit Partia Demokratike -Aleanca për Ndryshim (PD-AN) me objekt "Kundërshtimin e vendimit nr. 156, datë 17.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve" të marrë nga KAS, ku është legjitimuar subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë të merrte pjesë në këtë proces si palë e interesuar, për shkak të interesit të saj legjitim.

Pala e paditur pretendon se nuk ka analogji midis vendimit nr. 9/2021 të sipërcituar dhe rastit konkret vendimit nr. 32/2023 të KAS, pasi objekt shqyrtimi i vendimit të parë ka qenë implementimi i një rregulli të përgjithshëm për zgjedhjet, që i interesonte të gjithë subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhjet e atëhershme. Çështja nuk i përkiste vetëm Partisë Demokratike, por caktonte rregullat e garës elektorale. Në rastin konkret objekt shqyrtimi është vetëm marrëveshja e koalicionit, e cila si e tillë i përket vetëm subjekteve

pjesëmarrëse në koalicion. Marrëveshjet e koalicionit që depozitohen në KQZ janë çështje të brendshme të anëtarëve të koalicionit.

- Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër, KQZ vlerëson se paditësi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Bashkë Fitojmë" (BF), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi interesi i tij për të shprehur qartë se subjekti "Partia Demokratike e Shqipërisë" nuk ka vullnetin për të qenë pjesë e Koalicionit "Bashkë Fitojmë", ka gjetur zgjidhje nëpërmjet vendimit nr. 178/2023, duke regjistruar si pjesëmarrëse të këtij koalicioni vetëm tre partitë PL- PDK-PBDNJ. Për sa më sipër, kërkohet:

*Rrëzimi i kërkesëpadisë të paraqitur nga paditësi 'Partia Demokratike e Shqipërisë';*

*Lënien në fuqi të vendimit 32, datë 21.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve;*

*Lënien në fuqi të vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.*

10. Personi i tretë, koalicioni "BASHKË FITOJMË", nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit pretendoi se:

- Referuar vendimit të KAS-it që ankimohet në këtë Kolegj, personi i tretë pretendon se, organi administrativ kolegjal pra KAS, me vendimin nr. 32 datë 21.03.2023, ka vendosur: *Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023, të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë". Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.*

Duke ju referuar vendimarrjes, të vetë këtij Kolegji, personi i tretë çmon se, duhet t'i referohet këtu edhe vendimit analog nr. 1 datë, 09.05.2019, ku Kolegji shprehet se: (omissis...) *që padia të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore a) interesi i ligjshëm për të ngritur padi dhe b) legjitimiteti për të vepruar. Në rast se ekzistojnë këto dy kushte, mund të konsiderohet që padia ekziston në kuptimin*

*që për gjykatën del domosdoshmëria për të marrë vendim mbi themelin e saj, për të pranuar apo rrëzuar atë. Në lidhje me interesin e ligjshëm për të ngritur padi gjykata çmon se, interesi për të ngritur padi është një element i së drejtës së padisë. Ai dallon nga interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Kjo për arsye sepse janë të dallueshme dy të drejta, ajo materiale dhe ajo procedurale, që ushtrohet për mbrojtjen e së parës. Interesi për të ngritur padi, është një interes procedural dytësor dhe instrumental në lidhje me interesin material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës si mjet për arritjen e përmbushjes së interesit material i cili është çenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër ose nga gjendja faktike objektive ekzistuese. Pra, interesi për të ngritur padi lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi që mund të përmbushet duke kërkuar mbrojtjen në gjykatë. Interesi për të ngritur padi i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të çenuar.*

Duke u bazuar pikërisht në përmbajtjen e nenit 145 të Kodit Zgjedhor me të drejtë shtrohet pyetja se, cili është interesi i ligjshëm i paditësit dhe a i është çenuar interesi i ligjshëm, pra çfarë cenimi i është shkaktuar palës paditëse.

Në momentin e regjistrimit pranë K.Q.Z çdo subjekt zgjedhor, kryen këtë veprimtari me vullnetin e tij dhe pa patur dijeni paraprake se cili subjekt do të marrë pjesë në zgjedhje dhe sa do të jetë numri i tyre në këto zgjedhje. Në këtë rast çdo subjekt do të kishte interes të ligjshëm nëse nga K.Q.Z, ky subjekt do të regjistrohej apo jo, pas kërkesës që ai do t'i bënte K.Q.Z-së. Paditësi si subjekt zgjedhor është pranuar të regjistrohet nga K.Q.Z si i tillë për rrjedhojë nuk i është çenuar asnjë interes i tij.

Regjistrimi nga K.Q.Z-ja i çdo subjekti apo mosregjistrimi i tij nuk cenon interesat e subjekteve të tjerë të cilëve u është pranuar ose jo regjistrimi si subjekt zgjedhor. Subjekti zgjedhor përfshi dhe partitë politike, regjistrohen pa marrë parasysh se sa dhe cilat janë subjektet që do të regjistrohen nga K.Q.Z-ja. Fakti që një subjekt zgjedhor regjistrohet në zgjedhje dëshmon se interesat e tij të ligjshme lidhen vetëm me garën dhe realizimin e saj ndaj dhe kërkesa për ç'regjistrimin e një tjetër subjekti zgjedhor në këtë rast, nuk

përbën interesa të ligjshme të subjektit zgjeddhor, si kusht për ngritjen e kësaj padie në bazë të nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

- Në nenin 153/1/c të Kodit Zgjedhor përcaktohet se *palë të interesuara janë palët pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ pranë K.Q.Z.* Në rastin konkret pala paditëse nuk është palë pjesëmarrëse në shqyrtimin administrativ të K.Q.Z. (vendimi nr. 230 dt. 27.04.2019).
- Referuar gjithashtu edhe përmbajtjes së nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rezulton se, Kushtetuta garanton dhe mbron të drejtën për t'u organizuar kolektivisht për qëllime të ligjshme, sikundër është edhe e drejta për të krijuar parti politike, apo për të krijuar koalicione zgjedhore, me qëllimin pjesmarrjen në zgjedhje. Nuk mund të cënohet e drejta e askujt për t'u organizuar lirisht në një aleancë apo koalicion me qëllimin e ligjshëm për të paraqitur kandidatë e për të garantuar mbështetjen me votë. Kjo e drejtë garantohet nga vetë Kushtetuta dhe cënimi i kësaj lirie themelore do të përbënte një precedent tepër të rrezikshëm për demokracinë e brishtë në Shqipëri.

Nga ana tjetër vlen të theksohet, se organet kompetente vendimarrëse të PD i kanë marrë vendimet e tyre në lidhje me organet drejtuese të PD. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë i datës 3 Mars 2023 ka urdhëruar vetëm rishqyrtim nga shkalla e parë e vendimeve të Kuvendit të PD të 11 Dhjetorit 2021, pra Apeli i Juridiksionit të Përgjithshëm nuk i ka shfuqizuar ato vendime. Sa kohë vendimi i apelit nuk është zbardhur ende, ai vendim është i rekursueshëm me rekurs të veçantë dhe në çdo rast nuk është vendim final për zgjidhje në themel të çështjes në lidhje me organet legjitime përfaqësuese të Partisë Demokratike. Për më tepër, kjo çështje kjo nuk është çështje kompetencë e Kolegjit Zgjedhor.

- Nëse Kolegji është shprehur, ai është shprehur vetëm në lidhje me subjektin zgjedhor PD, pra për efekt të regjistrimit në procesin zgjedhor, por Kolegji as nuk ka tagër dhe kompetencë që eventualisht të shprehet për konflikte drejtimi të partisë, si dhe Kolegji nuk mund të shqyrtojë cili është subjekti politik PD dhe vendimet e PD për t'u organizuar për një qëllim të ligjshëm. Po ashtu, vendimi i KSHZ për regjistrimin e Koalicionit “Bashkë Fitojmë” nuk krijon konfuzion tek zgjedhësit as me logo e as me emërtim. Siç u theksua edhe më

parë, KSHZ e miratoi regjistrimin e koalicionit pa përfshirë PD si entitet. Ndaj ankuesit nuk kanë asnjë interes të ligjshëm.

Përkundrazi, interesi për të cenuar mënyrën e organizimit si subjekt zgjedhor të një Koalicioni i cili nuk përfshin as PD si subjekt, jo vetëm është i paligjshëm, por edhe antikushtetues, sikundër e theksuam edhe më lart.

Referuar Kodit Zgjedhor, ligjvënësi ka parashikuar qartë procedurën, hapat, etapat dhe afatet për regjistrimin e subjekteve dhe koalicioneve zgjedhore. Në këtë këndvështrim referuar përcaktimit të ligjvënësit, përkatësisht pikës së parë të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, qartazi parashikohet se:

1. Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
2. Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kushti i tretë është numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se, kërkesa për t'u regjistruar si koalicion, është e bërë nga tre nga partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. "Partia e Lirisë" me kryetar z. Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 154, datë 9.3.2023;
2. "Partia Demokratike e Shqipërisë" me kryetar z. Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 111, datë 8.3.2023;
3. "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut" me kryetar z. Vangjel Dule regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 135 datë 8.3.2023.

Përfundimisht, personi i tretë për sa më sipër kërkon:

*Rrëzimi i kërkesës ankimore të subjektin ankues PDSH*

*Lënia në fuqi e vendimit nr. 32 datë 23.03.2023 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS).*

## **II. DISPOZITA LIGJORE TË ZBATUESHME**

### **Kodi Zgjedhor**

Neni 65

Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore



1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.
2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.
3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.

Neni 145

E drejta e ankimit në gjykatë

1. Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.

### **III. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR:**

1. Kolegji zgjedhor vlerëson se, në nenin 65 të K.Zgjedhor parashikohet procedura e regjistrimit si subjekt zgjedhor e koalicionit të partive politike, kushtet që duhet të plotësojë një koalicion për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, afatin e regjistrimit etj.

2. Koalicioni i partive për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ duhet të plotësojë këto kushte:

- Koalicioni të përbëhet nga jo më pak se dy parti politike, të cilat kanë lidhur aktmarrveshje me njëra-tjetrën për të marrë pjesë në zgjedhjet politike si koalicion.
- Partitë politike pjesëmarrëse të koalicionit të jenë të regjistruara paraprakisht si subjekte politike në KQZ.
- Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.

- Koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit.

3.Nëse koalicioni paraqet para KQZ brenda afatit kohor ligjor kërkesën për regjistrim dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor që vërteton përmbushjen e këtyre kushteve ligjore, atëherë KQZ është e detyruar të regjistrojë këtë koalicion si subjekt zgjedhor.

4.Në nenin 145 të K.Zgjedhor parashikohen subjektet që kanë të drejtë dhe që legjitimohen të paraqesin padi në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së.

5.Të drejtën e paraqitjes e paraqitjes së padisë në Kolegjin Zgjedhor e kanë subjektet zgjedhore, me kusht që vendimi i KQZ-së të cenojë interesat e tyre të ligjshme.

Të drejtën e ngritjes ë padisë e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor nga ana e KQZ-së.

Në këtë rast Kolegji Zgjedhor kryhen hetimin gjyqësor dhe kontrollon ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara nga paditësi të KQZ-së (Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe KAS-it).

6.Në rastin konkret Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi dëgjoi pretendimet e palëve ndërgjyqëse shqyrtoi provat e paraqitura në gjykim vlerëson se, padia e paditësit Partia Demokratike e Shqipërisë duhet rrëzuar nga Kolegji Zgjedhor.

Paditësi nuk provoi para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor se, vendimet e kundërshtuara me padi nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS dhe vendimi nr.178, datë 18.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, cenojnë interesat e saj të ligjshme.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se, vendimet e kundërshtuara me padi nga paditësi të sipërpërmendura janë të ligjshme dhe pretendimet në padi të paditësit janë të pabazuara në ligj.

7.Me të drejtë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.178, datë 18.03.2023 ka vendosur të regjistrojë si subjekt zgjedhor koalicionin “Bashkë Fitojmë” “BF” me këto parti pjesëmarrëse: a) Partia e Lirisë, b) Partia Demokristiane e Shqipërisë dhe c) Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë parasysh në këtë vendim që kundërshtohet me padi, pretendimet e palës paditëse në këtë gjykim që ajo, nuk ka vullnet të shprehur sipas ligjit për të qenë pjesë e këtij koalicioni dhe ka vendosur që koalicioni të regjistrohet si subjekt zgjedhor me tre partitë e sipërpërmendura pa Partinë Demokratike të Shqipërisë. Në të tilla rrethana Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me të drejtë ka lënë pa fuqi juridike marrveshjen për krijimin e këtij koalicioni të datës 15.03.2023, për pjesën ku pasqyrohet në këtë marrveshje emri i Partisë Demokratike të Shqipërisë, në kushtet kur kjo e fundit nuk ka shprehur vullnet sipas ligjit për të qenë pjesë e këtij koalicioni dhe nuk ka qenë e regjistruar paraprakisht si subjekt zgjedhor. Pjesa tjetër e marrveshjes së koalicionit të tre partive të sipërpërmendura mbetet në fuqi dhe nuk ka asnjë arsye ligjore të refuzohet me vendim regjistrimi i këtij koalicioni si subjekt zgjedhor nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

8.Ky koalicion prej tre partish politike (pa Partinë Demokratike të Shqipërisë) i plotëson të gjitha kushtet ligjore të parashikuara në nenin 65 të K.Zgjedhor për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje, dhe ka të përcaktuar Partinë Udhëheqëse të këtij koalicioni Partinë e Lirisë. Pasqyrimi në mënyrë joligjore në këtë marrveshje koalicioni në këto rrethana e Partisë Demokratike të Shqipërisë, nuk cenon ligjshmërinë e kësaj marrveshje për pjesën tjetër lidhur me tre partitë e tjera pjesë të këtij koalicioni të sipërpërmendura.

9.Nuk jemi në kushtet kur Partia Demokratike e Shqipërisë të ishte pasqyruar në këtë marrveshje si partia politike udhëheqëse e këtij koalicioni, çka do të përbëntë një shkak për mosplotësimin e kushteve ligjore për regjistrimin e këtij koalicioni. Partia politike udhëheqëse e këtij koalicioni është përcaktuar Partia e Lirisë. Gjithashtu nuk jemi në kushtet kur ky koalicion pa emrin e Partisë Demokratike të Shqipërisë nuk plotëson kushtin ligjor të përbërjes nga jo më pak se dy parti, pasi partitë pjesëmarrëse në këtë koalicion pa emrin e paditësit mbeten tre parti.

10.Pretendimi i paditësit në padi se, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim duhet të ishte vendosur që emri i Partisë Demokratike të Shqipërisë të ishte hequr nga aktmarrveshja pasi cënon interesat e paditësit në këtë gjykim, është një pretendim i pabazuar në ligj, përse kohë kësaj marrveshje për emrin e paditësit nuk i është dhënë fuqi juridike me vendim nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe në fletën e votimit nuk do të pasqyrohet emri i paditësit si pjesë e këtij koalicioni.

11.Pretendimi i paditësit se pavarësisht këtij vendimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ekzistena e emrit të paditësit në këtë aktmarrvëshje, sjell konfuzion të zgjedhësve është një pretendim përveçse i pabazuar në ligj edhe i pabazuar në prova.

Përsa kohë ajo aktmarrvëshje është pa fuqi juridike për paditësin e përsa kohë nuk pasqyrohet emri i paditësit si pjesë e atij koalicioni në fletën e votimit, nuk ka sesi të sjellë konfuzionin e zgjedhësve ekzistenca formale (pa fuqi juridike) e emrit të paditësit në këtë marrvëshje të datës 15.03.2023.

12.Lidhur me pretendimin e paditësit se, mund të përdoren simbolet e Partisë Demokratike të Shqipërisë nga Koalicioni i regjistruar “Bashkë Fitojmë”, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, asnjë subjekt zgjedhor nuk mund të përdorë simbolet e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përveç kësaj të fundit. Ky pretendim i paditësit nuk lidhet me ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara me padi nga paditësi, por me veprime që pala paditëse pretendon se mund të kryejnë persona apo subjekte të tjera zgjedhore. Në këto kushte paditësi nuk mundet që për këtë shkak të kundërshtojë vendimet e palës së paditur, përsa kohë këto të fundit janë të ligjshme.

Në të tilla rethana vendimi nr.178, datë 18.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vlerësohet se është një vendim i ligjshëm.

13.Me të drejtë KAS nuk e ka legjitimuar në procesin administrativ të zhvilluar para tij palën paditëse në këtë gjykim, dhe ka marrë vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023, për mospranimin për shqyrtimin të kërkesës ankimore të palës paditëse.

Pala paditëse i ka realizuar interesat e saj të ligjshme në procesin administrativ të zhvilluar para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku është marrë vendimi nr.178, datë 18.03.2023 dhe nuk mbronte asnjë interes të ligjshëm kur kundërshtonte me ankim në KAS vendimin nr.178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

14.Për të njëjtat arsye të parashtruara në vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS, Kolegji Zgjedhor vlerëson se, pala paditëse nuk mbron interesa ligjore para Kolegjit Zgjedhor kur kundërshton me padi vendimin nr.178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimin Nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS, përsa kohë me këto vendime nuk janë cenuar interesat e ligjshme të palës paditëse, në kuptim të nenit 145/1 të K.Zgjedhor.

Për këto arsye padia e paditësit duhet rrëzuar nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor për të gjitha kërkimet e saj.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

## **V E N D O S I**

- Rrëzimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palëve, siç janë kryer
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë më datë 30.03.2023.

**GJYQTARE**  
**Manjola XHAXHO**

**GJYQTARE**  
**Edlira PETRI**  
**(kundër)**

**GJYQTAR**  
**Sokol IBI**

**GJYQTARE**  
**Alma KOLGJOKA**

**GJYQTARE**  
**Esmeralda XHILI**

**SEKRETARE**  
**Ermelinda NURAJ**